

VENDIM
Nr. 449, datë 22.5.2013

**PËR AUTORIZIMIN E “GENERAL POLYMEREN RECYCLING ALBANIA” SHPK, PËR
IMPORTIN E MBETJEVE TË PLASTIKËS PËR QËLLIME RICIKLIMI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 22 të ligjit nr. 8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar dhe të pikës 2 të nenit 49 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e “General Polymeren Recycling Albania” sh.p.k. për importin e mbetjeve të plastikës me kodin tarifor:

- GH 010 3915;
- GH 011 ex 391510;
- GH 014 ex 391590;
- B1-B3010,

të Konventës së Bazelit, sipas aneksit 1 “Mbetjet e listës së gjelbër”, bashkëlidhur vendimit nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi”, të ndryshuar.

2. Sasia e mbetjeve të plastikës që importohet, sipas kodeve të referuara në pikën 1 të këtij vendimi, është 4500 (katër mijë e pesëqind) tonë në vit.

3. Mbetjet importohen nga vendet e Bashkimit Europian dhe nga shtetet e Maqedonisë, Kosovës, Malit të Zi, Serbisë, Turqisë, Bosnjë-Hercegovinës, Amerikës së Veriut, Amerikës së Jugut dhe Afrikës. Transporti bëhet në rrugë tokësore dhe detare, duke plotësuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor për transportin ndërkombëtar të mbetjeve, si dhe kërkesat e kreut II të vendimit nr. 806, datë 4.12.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për importimin e mbetjeve për përdorim, përpunim dhe riciklim”, dhe anekseve 3 e 4 të vendimit nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

4. Për çdo transfertë ndërkufitare të mbetjeve “General Polymeren Recycling Albania” sh.p.k. dorëzon të plotësuar në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dokumentin e lëvizjes/transfertës ndërkufitare të mbetjeve, sipas formatit të dhënë në anekset 3 e 4 të vendimit nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar dhe monitorimi i tyre kryhet nga strukturat përkatëse të autoriteteve doganore. Çdo transfertë mbetjesh duhet të jetë e pajisur me raportanalizë të kryer për aspektin e radioaktivitetit.

5. Periudha e lejimit të importit të mbetjeve të plastikës nga “General Polymeren Recycling Albania” sh.p.k. është njëvjeçare dhe fillon me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

6. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në zbatim të kërkesave të mësipërme ligjore dhe për të siguruar mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit publik, të marrë masat e nevojshme për kontrollin e procesit të riciklimit të mbetjeve të plastikës nga “General Polymeren Recycling Albania” sh.p.k., pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave komunikon me shkrim, me shtetet eksportuese dhe ato transitore për autorizimet përkatëse që lejojnë kalimin e kësaj sasive të mbetjeve të plastikës, në përmbushje të kërkesave të Konventës së Bazelit “Për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre”, në të cilën Republika e Shqipërisë është palë.

8. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha